



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.151 dt.29.09.1997

**PER MIRATIMIN E FONDEVE PER RIKONSTRUKSIONIN
DHE VENDOSJEN NE AMBJENTE TE REJA TE ZYRAVE
TE NJESIVE ADMINISTRATIVE NR.3, 4 DHE 6.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.29.09.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për miratimin e fondeve për rikonstruksionin dhe vendosjen në ambjente te reja të zyrave të Njësive Administrative Nr.3, 4 dhe 6, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Të miratohet fondi prej 1.300.000 lekë për adaptimin e ambjenteve të ish ndërmarrjes së Galanterisë në zyra për Njësitë Administrative Nr.3 dhe 4.
2. Të miratohet fondi prej 740.000 lekë për adaptimin e ambjenteve të Postë së Kombinatit në zyra për Njësinë Administrative Nr.6.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

